Miratimi i llogarive te shoqerise behet nga asambleja e ortakeve brenda nje afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

KREU V

Marredheniet e punes

Neni 20

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet dispozitave te Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise.

Te gjithë personat e punesuar ne shoqerine "IT.COM ALBANIA"SH.P.K, kane te drejte t'i percaktojne marredheniet e punes ne kete shoqeri nepermjet Kontrates se Punes.

Neni 21

Mosmarveshjet mbi marredheniet e punes zgjidhen nga Gjykata, kur mjetet e tjera nuk japin rezultat .

Shoqeria respekton rregullat e punesimit dhe te sigurimeve shoqerore, kurse te punesuarit jane te detyruar qe te pranojne dhe te zbatojne rregullat e Kodit te Punes, ketij statuti, rregulloreve te brendshme te shoqerise, kontrates se punes etj.

Te gjithë te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes.

KREU VI

Mbarimi i Shoqerise

Neni 22

Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendim te arsyetuar te ortakeve ne rastet e parashikuara me ligj.

Likuidimi i Shoqerise

Neni 23


Shperndarja e shoqerise per cdo lloj arsye, pervec falimentimit, behet nepermjet likuidimit. Perderisa kryhet ky veprim quhet se vazhdon funksioni i shoqerise.

Shoqeria e mban emrin e vet ne te cilin shtohet fjala " Ne likuidim e siper "duke bere veprimet e duhura ne regjistrin tregetar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Likuidimi i shoqerise vendoset me vendim te arsyetuar te ortakeve, te cilët per te kryer veprimet e likuidimit emerohen nje likuidator me tagrat e percaktuara ne ligjin " Per shoqerite tregetare ". Likuidatori i emeruar eshte pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu edhe ndaj te treteve per pasojat dempruese te gabimeve qe ai ka bere gjate ushtrimit te funksioneve te tij.

Likuidatori i emeruar perfaqeson shoqerine dhe nenshkruan duke vene firmen poshte vules se shoqerise. Ai duhet te perfundoje shitjet qe jane te disponueshme per llogari te shoqerise. Ai duhet te marre nga cdo debitor, llogari te sakta ne monedhe dhe te ktheje pasurine e shoqerise ne para.

Kompetencat e likuiduesit do te percaktohen ne aktin e emerimit.



Likuiduesi, ne rast se asambleja e ortakeve eshte e pamundur ose ne rast se nuk arrihet te merret asnje vendim ne te, kerkon nje autorizim te nevojshem ligjor per realizimin e likuidimit, sipas te cilit merr te gjitha atributet e asamblese se ortakeve, duke ruajtur te drejten e njoftimit per punet e shoqerise.

Per ceshtjet qe kane mbetur pezull administratoret e shoqerise (ortaket) kane te drejte te vendosin per zgjidhjen e tyre.

Per perfundimin e likuidimit, likuidatori detyrohet te perpiloje bilancin perfundimtar dhe te nxjerre buletinin .

KREU VII

Dispozita te Pergjithshme


Neni 24

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit nr. 7638 dt. 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare " dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Ndryshimet dhe plotesimet ne kete statut do te behen ne te njejten menyre dhe procedure me te cilen hartohet dhe miratohet statuti .

ORTAKET E SHOQERISE

Arni PONARI Leon NIMANI Vlahovic DARKO



STATUT

I

SHOQERISE "IT.COM ALBANIA"SH.P.K

KREU I

Emertimi, Qendra, Objekti i Veprimtarise, Jetegjatesia

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "IT.COM ALBANIA"SH.P.K eshte prone e ortakeve Avni Ponari, Leon Nimani dhe Vlahovic Darko.

Neni 2

Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor, Tirane. Ajo eshte person juridik shqiptar dhe zhvillon aktivitet ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe normat e akteve te saj themeluese.

Neni 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise "IT.COM ALBANIA"SH.P.K eshte:

1. Prodhim dhe montim i kompjuterave dhe makinave per zyra;
2. Konsulence lidhur me pajisjet dhe rrjetet kompjuterike;
3. Prodhim dhe konsulence e programeve kompjuterike;
4. Ngritja e database
5. Mirembajtje dhe riparime te kompjuterave, pajisjeve te zyrave dhe makina llogaritese;
6. Aktivitete te tjera te lidhura me kompjuterat dhe rrjetet kompjuterike;
7. Menaxhim, konsulence dhe organizim aktivitetesh te ndryshme;
8. Sherbime te tjera marketing dhe publiciteti;
9. Transport tokesor dhe ujqor i mallrave;
10. Sherbime ne transportin rrugor;
11. Dhenie me qira objekte per perdorim vetjak, pajisje shtepiake;
12. Ndermjetesim ne shitje makinerish, pajisjesh industriale, anijesh dhe avionesh;
13. Ndermjetesim ne shitje te specializura, me shumice dhe pakice, te produkteve te vecanta ose grup produktesh, lidhur me IT dhe telekomunikacionin.
14. Prodhim, shitje me shumice dhe pakice pajisjesh elektroshtepiake, pajisje elektrike dhe elektronike dhe aksesoresh te lidhur me to;
15. Shitje me shumice dhe pakice pajisje dhe makineri zyrash;
16. Shitje me shumice dhe pakice te makinerive te tjera industriale per transport dhe navigim;
17. Dyqane shitje me pakice te mallrave te perziera (ushqimore, kancelari);
18. Zyra sherbimi postar dhe sherbime te tjera te lidhura me to;
19. Publikim broshura, revista, botime perodike, libra, printime, etj;
20. Prodhime dhe riprodhime audio - vizuale, filma, media kompjuterike;
21. Aktivitete te ndryshme ligjore, financiare qe lidhen me IT;



Neni 4

Shoqeria e ka seline ne Tirane, Rr:“Kavajes“, Pallati i Ri i Madh tek ish Parku i Udhetareve, Shk.1.

Me vendim te asamblese se ortakeve te shoqerise mund te krijohen dege, filiale apo agjenci brenda dhe jashte vendit.

Neni 5

Jetegjatesia e shoqerise eshte e pakufizuar. Shoqeria mund te pushoje veprimtarine e saj perpara ketij afati me vendim te ortakeve apo kur verifikon rrethana te tilla kur shperdarja e saj urdherohet ne menyre te shprehur nga ligji.

KREU II

Kapitali Themeltar i Shoqerise

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000(njeqind mije) Leke, i ndare ne 100 pjese me vlere nominale 1000 (njemije) leke secila shume qe do te shlyhet teresishte nga ortakët themelues.

Perberja e kapitalit te shoqerise eshte si me poshte:

<u>Emri,mbiemri</u>	<u>perqindja</u>	<u>Nr. i pjeseve</u>
Avni PONARI	34%	34
Leon NIMANI	33%	33
Vlahovic DARKO	33%	33

Neni 7

Transferimi i kapitalit themeltar ne cdo rast si tek te tretet ashtu dhe ndermjet ortakeve do te behet konform dispozitave te Nenit 47 te ligjit “Per shoqerite Tregtare“.

KREU III

Organet e Shoqerise, Administrimi

Asambleja e Ortakeve

Neni 8

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise. Asaj i takojne te gjitha kompetencat e percaktuara ne ligjin per shoqerite tregtare si pjesemarrja e shoqerise ne shoqeri te tjera, plotesime e ndryshim ne statut, miratim bilancesh vjetore dhe periodike, shperberje e shoqerise, percaktimi i politikës ekonomike te shoqerise, pranimi i ortakeve te rinj, shtimi apo pakesimi kapitalit.

Vendimet e asamblese regjistrohen ne librin e shoqerise.

Neni 9

Asamblete e pergjithshme te ortakeve sipas natyres se vendimeve qe ato jane thirrur per te marre kerkojne nje quorum te caktuar votash.
Vendimet e asamblese se ortakeve merren nga nje ose disa ortake qe perfaqesojne me shume se gjysmen e kapitalit te shoqerise.

Vendimet e asamblese se ortakeve te thirrura per ndryshime ne Statut kerkojne miratimin e ortakeve qe perfaqesojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.
Nje ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjetër me autorizim.
Ai mund te perfaqesohet nga nje person tjetër vetëm me prokure te posacme per kete qellim.

Neni 10

Vendimet e Asamblese se ortakeve mund te merren pas konsultimit me shkrim te ortakeve, ne rast se te gjithë ortakët miratojne me shkrim permbajtjen e konsultimit.

Lajmerimet per mbledhje te asamblese behen nga Administratori ose, ne mungese te tij, nga eksperti kontabel i pavarur, dhe ne rast urgjence, nga nje mandatmbajtes i caktuar nga gjykata dhe kur eshte rasti nga likujduesi.

Asamblete e pergjithshme mblidhen ne selin e shoqerise, ose ne cdo vend tjetër te treguar ne thirrje.

Thirrja e asamblese se ortakeve, behet me ane te njoftimit qe i dergohet cdo ortaku te pakten 15 dite perpara mbledhjes se asamblese dhe duhet te permbaje ditën, oren, vendin e mbledhjes dhe rendin e dites.

Neni 11

Cdo i interesuar mund te kerkoje ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane anulimin e Vendimeve te Asamblese se ortakeve te marra ne kundërshtim me ligjin akt - themelimin apo normat e ketij statuti .

Administratori

Neni 12


Administrator i shoqerise "IT.COM ALBANIA"SH.P.K eshte Znj. Ermira QOSJA, i bija e Shaqirit, e dtl. 07.04.1966, banues ne Tirane, Rr. Kongresi i Lushnjes, Pall. 40, Shk. 10, Ap. 119, identifikuar me leternjoftimin QH nr. 284886. Mandati i administratorit eshte i pakufizuar, persa nuk eshte vendosur ndryshe nga asambleja e ortakeve.

Administratori shkarkohet vetëm me vendim te ortakeve qe perfaqesojne me teper se gjysmen e pjeses te kapitalit themeltar, ose nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkese te cdonjerit prej ortakeve.

Neni 13

Administratori kryen cdo veprimtari ne interes te shoqerise brenda objektit te veprimtarise se saj. Administratorit i takon firma e shoqerise dhe perfaqesimi i saj ndaj te treteve, ne organet gjyqesore, te caktoje e pushoje avokate per ceshtje ne gjykim si dhe ne marrëdhënie me organet shteterore, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ua jep shprehimisht ortakeve.
Gjithë veprimtaria e shoqerise ne aspektin ekonomik drejtohet nga administratori.

Administratori i emeruar ose i autorizuar nuk mund te marre cilesine e ortakut te shoqerise dhe si individ nuk mund te kontraktoje ne cfaredolloj forme qofte, nuk mund te marri hua nga shoqeria, te jap pelqimin ne emer te saj, per paradhënie si dhe



te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme.

Per cdo shkelje ne kete drejtim ai pergjigjet sipas dispozitave ne fuqi.

Neni 14

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit dhe kur keto nuk/perfshihen ne objektin e veprimtarise se saj me perjashtim te rasteve kur provohet se/te tretet e dinin se akti i administratorit tejkalonte objektin e shoqerise, kompetencat e saj apo kur rrethanat nuk mund ta injoronin kete fakt.

Kontrolli i pavarur, Eksperti kontabel i autorizuar

Neni 15

Eksperti kontabel i autorizuar emerohet nga asambleja e ortakeve me shumice te zakonshme nga nje ose disa ortake qe perfaqesojne me shume se gjysmen e kapitalit te shoqerise.

Shperblimi i eksperteve te pavarur caktohet nga asambleja e ortakeve dhe perballohet nga shoqeria.

Detyrat dhe te drejtat e ekspertit te pavarur te shoqerise, jane ato te parashikuara nga ligji "Per shoqerite tregtare" dhe nga aktet e tjera ne fuqi qe rregullojne kete profesion. Asambleja e ortakeve mund t'u kerkoje eksperteve te pavarur kryerjen e kontrolleve, apo verifikimeve te posacme per ceshtje ne interes te shoqerise.

KREU IV

Bilanci dhe Fitimet

Neni 16

Viti financiar i shoqerise fillon me 01.01 dhe mbyllet ne daten 31.12. te cdo viti. Ne kete rast administratori ben inventarin dhe llogarite vjetore sipas dispozitave per kontabilitetin dhe hartojne nje raport me shkrim per administrimin. Bilancit i bashkohen:

Nje situacion per garancite e dhena nga shoqeria .

Nje situacion per sigurimet e bera nga shoqeria .

Neni 17

Shoqeria nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar, pasi te jene zbritur po te jete e nevojshme humbjtet e vitit te meparshem, lene menjane nje shume me vlere te pakten 1/20 e tij, e cila destinohet per formimin e "rezerves se domosdoshme".


Kjo lenie menjane nuk eshte me e detyrueshme kur "rezerva e domosdoshme" arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

Neni 18

Fitimet, pasi te jene depozituar shumat e urdheruara per rezerven, i takojne ortakeve si dividend ne raport me perqindjet e kapitalit te vendosur nga cdo ortak gjate vitit ushtrimor.

Neni 19

Bilanci vjetor duhet te paraqitet ne organet tatimore brenda afateve ligjore te parashikuara me ligj, i cili aktualisht eshte 31.03 i vitit pasardhes.



Miratimi i llogarive te shoqerise behet nga asambleja e ortakeve brenda nje afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

KREU V

Marredheniet e punes

Neni 20

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet dispozitave te Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise.

Te gjithe personat e punesuar ne shoqerine "IT.COM ALBANIA"SH.P.K, kane te drejte t'i percaktojne marredheniet e punes ne kete shoqeri nepermjet Kontrates se Punes.

Neni 21

Mosmarveshjet mbi marredheniet e punes zgjidhen nga Gjykata, kur mjetet e tjera nuk japin rezultat .

Shoqeria respekton rregullat e punesimit dhe te sigurimeve shoqerore, kurse te punesuarit jane te detyruar qe te pranojne dhe te zbatojne rregullat e Kodit te Punes, ketij statuti, rregulloreve te brendshme te shoqerise, kontrates se punes etj.

Te gjithe te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes.

KREU VI

Mbarimi i Shoqerise

Neni 22

Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendim te arsyetuar te ortakeve ne rastet e parashikuara me ligj.

Likuidimi i Shoqerise

Neni 23

Shperndarja e shoqerise per cdo lloj arsye, pervec falimentimit, behet nepermjet likuidimit. Perderisa kryhet ky veprim quhet se vazhdon funksioni i shoqerise.

Shoqeria e mban emrin e vet ne te cilin shtohet fjala " Ne likuidim e siper "duke bere veprimet e duhura ne regjistrin tregetar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Likuidimi i shoqerise vendoset me vendim te arsyetuar te ortakeve, te cilet per te kryer veprimet e likuidimit emerone nje likuidator me tagrat e percaktuara ne ligjin " Per shoqerite tregetare ". Likuidatori i emeruar eshte pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu edhe ndaj te treteve per pasojat demprurese te gabimeve qe ai ka bere gjate ushtrimit te funksioneve te tij.

Likuidatori i emeruar perfaqeson shoqerine dhe nenshkruan duke vene firmen poshte vules se shoqerise. Ai duhet te perfundoje shitjet qe jane te disponueshme per llogari te shoqerise. Ai duhet te marre nga cdo debitor, llogari te sakta ne monedhe dhe te ktheje pasurine e shoqerise ne para.

Kompetencat e likuiduesit do te percaktohen ne aktin e emerimit.



Likuiduesi, ne rast se asambleja e ortakeve eshte e pamundur ose ne rast se nuk arrihet te merret asnje vendim ne te, kerkon nje autorizim te nevojshem ligjor per realizimin e likuidimit, sipas te cilit merr te gjitha atributet e asamblese se ortakeve, duke ruajtur te drejten e njoftimit per punet e shoqerise.

Per ceshtjet qe kane mbetur pezull administratoret e shoqerise (ortaket) kane te drejte te vendosin per zgjidhjen e tyre.

Per perfundimin e likuidimit, likuidatori detyrohet te perpiloje bilancin perfundimtar dhe te nxjerre buletin .

KREU VII

Dispozita te Pergjithshme

Neni 24

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit nr. 7638 dt. 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare " dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.


Ndryshimet dhe plotesimet ne kete statut do te behen ne te njejten menyre dhe procedure me te cilen hartohet dhe miratohet statuti .

ORTAKET E SHOQERISE

Avni POMARI

Leon NIMANI

Vlahovic DARKO

The image shows three handwritten signatures in black ink. The first signature on the left is for Avni Pomari, the middle one is for Leon Nimani, and the one on the right is for Vlahovic Darko. Each signature is written over its respective printed name.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Noter: Robert KOLI

Studio: Rr. "Urani Pano", Pallati 11/Katesh

Nr. 14691 Rep.

Nr. 2761 Kol.



VERTETIM NOTERIAL

Sot, me daten 04/09/2006 (dymije e gjashte), ditën e Heve, para meje Robert KOLI, noter ne qytetin e Tiranës, me Seli si me siper, u paraqiten personalisht:

Z. Avni PONARI, i biri Rexhepit, lindur me 28.07.1957 ne Tropoje dhe banues ne Tirane, Rr. "Nikolla Tupe", Pallati 11-katesh, identifikuar nga Pasaporta me Nr. Z1262110,


Z. Vlahovic DARKO, i biri i Momcila, lindur me 31.03.1970 ne Podgorica, P. Matovica dhe banues ne Podgorica, P. Matovica identifikuar nga Pasaporta e Republikës Federale te Jugosllavise Nr. 002280802,

Z. Leon NIMONI, i biri i Saliut, lindur me 08.03.1976 ne Kosove dhe banues ne Tirane, Pallatet Moskat, identifikuar nga Pasaporta e Republikës Federale te Jugosllavise Nr. 005103438,

te gjithë madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet me deklaruan se **Akt themelimin dhe Statutin e Shoqerise "IT.COM ALBANIA" SHPK** e bashkangjitur e kane hartuar me vullnet te lire dhe e neshkruan rregullisht para meje.

Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTER
Robert KOLI



VENDIM Nr. 4

Date 21.06.2007



I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME
TE ORTAKEVE TE SHOQERISE

“IT COM ALBANIA“ SH.P.K.

Sot me date 21.06.2007, prane selise se shoqerise “IT COM ALBANIA“ SH.P.K. ne Tirane, regjistruar si person juridik ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane me Vendimin Nr. 36343 date 15.09.2006 te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane, dhe ndryshimet me Vendimin nr. 36343/1 dt. 10.11.2006, Vendimin nr. 36343/2 date 26.12.2006 dhe Vendimin nr. 36343/3 date 05.04.2007 te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane, u mblodh Asambleja e Ortakeve te Shoqerise:

Z.Gani AGA, zoterues i 34% te kapitalit,

Z.Leon NIMANI, zoterues i 33% te kapitalit,

Z.Vlahovic DARKO, zoterues i 33% te kapitalit.

Pasi u shqyrtua ecuria e deritanishme e shoqerise tone si me lart, mbeshtetur ne Statutin e shoqerise, ne perputhje te plote me legjislacionin ne fuqi, me 100% te votave, ne ortaket e shoqerise

VENDOSEM:

1. T'i shesim Z. Sokol Kaso aksionet qe secili ortak zoteron ne shoqerine “IT COM ALBANIA“ SH.P.K. ne masen 2 % (dy) te kapitalit themeltar secili ortak dhe ne total 6% (gjashte) te kapitalit themeltar te shoqerise, duke lidhur me te Kontraten e Shitblerjes se kuotave para noterit.
2. Te shkarkojme nga detyra e Administratorit te shoqerise IT COM ALBANIA shpk, Z. Gani Aga.
3. Te emerojme si Administrator te shoqerise IT COM ALBANIA shpk, Z. Sokol Kaso.
4. Te depozitohet dokumentacioni i nevojshem prane Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane, per te bere ndryshimet e nevojshme ne Regjistrin perkates.
5. Caktimin e administratorit te shoqerise “IT COM ALBANIA“ SH.P.K. te depozitoje ndryshimet ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane.
6. Vendimi hyn ne fuqi menjehere.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Shoqeria “IT COM ALBANIA“ SH.P.K.

Gani AGA

Leon NIMANI

Vlahovic DARKO

Leon NIMANI

VLAHOVIC DARKO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 2482 REP.

714/3 del.

VERTETIM

Sot ne daten 7.7. 2007 (dymije e shtate), para meje notere Edlira Hyzeni,
notere ne qytetin e Tiranes, me Seli Buletariol Zop. I, u paraqiten
personalisht:

Z. Gani AGA, i biri i Muratit, lindur me 18.01.1971 ne Puke, me banim ne Tirane,
Qender-Kamez, identifikuar nga pasaporta Z0570888,

Z. Leon NIMONI, i biri i Saliut, lindur ne 08.03.1976 ne Kosove, banues ne Tirane,
Pallatet Moskat, identifikuar nga pasaporta e Republikes Federale te Jugosllavise Nr.
005103438,

Z. Vlahovic DARKO, i biri i Momcila, lindur me 31.03.1970 ne Podgorica,
P.Matovica dhe banues ne Podgorice, P.Matovice, identifikuar nga Pasaporta e
Republikes Federale te Jugosllavise Nr. 002280802,
te gjitha madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet ne pranine e
perkthyesit te gjuhes serbe Leon Nimani me deklaruan se Vendimin e Asamblese se
Ortakeve te Shoqerise "IT COM ALBANIA" SH.P.K. te bashkangjitur e kane hartuar
dhe nenshkruar me vullnet te lire.

Une noterja e vertetoi ate sipas ligjit.

Perkthyes
Leon NIMONI

Notere

NOTERE
EDLIRA S. HYSENI
069 2074797
FOLEZA@YAHOO.com



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 2485 REP.
717/2 Kol.



Talasa paguar
[Signature]

KONTRATE PER SHITJE KUOTASH

Sot ne daten 7.7. 2007 (dymije e shtate), para meje notere E. Hyqeriu, me seli ne Tirane, Bulevardi Zogu I, u paraqiten personalisht:

SHITESIT:

1. **Z. Leon Nimani**, i biri i Saliut, me dtl. 08.03.1976, me banim ne Tirane, Pallatet Moskat, identifikuar nga pasaporta e Republikes Federale te Jugosllavise Nr. 005103438,
2. **Z. Vlahovic Darko**, i biri i Momcila, me dtl. 31.03.1970, me banim ne Podgorica, P.Matovica, identifikuar nga pasaporta e republikes Federale te Jugosllavise nr. 002280802,
3. **Z. Gani Aga**, i biri i Muratit, me dtl. 18.01.1971, me banim ne Sauk, Tirane, identifikuar nga pasaporta Nr. Z0570888.

BLERESI:

Z. Sokol Kaso, i biri i Selfos dhe i Feruzes, me dtl. 18.08.1974, me banim ne Tirane, Bulevardi Zogu I, P.13, kati 9/3, identifikuar me pasaporten Z1024125, te gjithë madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si me poshte vijon:

Shitesit jane aksionere te shoqerise IT COM ALBANIA SHPK, regjistruar si person juridik ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane me Vendimin Nr. 36343 date 15.09.2006 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, dhe ndryshimet me Vendimin nr. 36343/1 dt. 10.11.2006, Vendimin nr. 36343/2 date 26.12.2006 dhe Vendimin nr. 36343/3 date 05.04.2007 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ne perkatesisht secili si vijon:

- Z.Gani AGA**, zoterues i 34% te kapitalit themeltar,
- Z.Leon NIMANI**, zoterues i 33% te kapitalit themeltar,
- Z.Vlahovic DARKO**, zoterues i 33% te kapitalit themeltar.

Shitesit me vullnetin e tyre te lire, ne mbeshtetje te Vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "IT COM ALBANIA" SH.P.K. nr. 4 date 21.06.2007, kane vendosur t'i shesin Z. Sokol Kaso aksionet qe secili ortak zoteron ne shoqerine "IT COM ALBANIA" SH.P.K. ne masen 2 % (dy) te kapitalit themeltar secili ortak dhe ne total 6% (gjashte) te kapitalit themeltar te shoqerise, me cmimin e shitjes prej 2.000 (dymije) Leke secili ortak, ne total 6.000 (gjashtemije) Leke, shume kjo e cila eshte likujduar plotesisht nga bleresi ne favor te secilit shites, ne perputhje me pjesen takuese pekatese, jahste kesaj zyre noteriale, pa asnje pretendim te metejshem nga palet.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitesit: **Z.Gani AGA**, **Z.Leon NIMANI** dhe **Z.Vlahovic DARKO** humbasin pronesine mbi 2% te aksioneve te shoqerise "IT COM

[Signatures]

[Signature]

[Signature]

ALBANIA“ SH.P.K. secili dhe pronar i tyre behet Z. Sokol Kaso, duke e regjistruar kete blerje ne Regjistrin Tregetar prane Gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane. Perfundimisht me kete Kontrate Shitje, aksionet e shoqerise “IT COM ALBANIA“ SH.P.K. rezultojne si vijon:

Z. Gani AGA, me 32% te kapitalit themeltar,
Z. Leon NIMANI, me 31% te kapitalit themeltar,
Z. Vlahovic DARKO, me 31% te kapitalit themeltar,
Z. Sokol KASO, me 6% te kapitalit themeltar.

Kjo kontrate shitje perpilohet ne baze te Vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise “IT COM ALBANIA“ SH.P.K. nr. 4 date 21.06.2007, bashkangjitur kesaj kontrate.

Kontrata u perpilua ne 5 kopje me vlere te njejte ligjore dhe pasi u lexua ne prezence te paleve me ze te larte, u nenshkrua rregullisht prej tyre para meje. Une noterja e vertetoj sipas ligjit.

SHITESIT

Gani AGA

Leon NIMANI

Vlahovic DARKO

Gani AGA *Leon NIMANI* *Vlahovic DARKO*

BLERESI

Leon NIMANI *VLAHOVIC DARKO*

Sokol KASO

Sokol KASO

NOTERE

NOTERE
EDLIRA S. HYSENI
069 2074797
FRIFZA@YAHOO.com

Edlira S. Hyse

Tirane, me 18.09.2007

A U T O R I Z I M

Shoqeria "IT COM ALBANIA" SH.P.K. ne Tirane eshte regjistruar si person juridik ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane me Vendimin Nr. 36343 date 15.09.2006 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, dhe ndryshimet me Vendimin nr. 36343/1 dt. 10.11.2006, Vendimin nr. 36343/2 date 26.12.2006 dhe Vendimin nr. 36343/3 date 05.04.2007 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Me Vendimin nr. 36343/4 date 10.07.2007 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte vendosur: Depozitimi i ndryshimeve te miratuara me Vendimin nr. 4 date 21.06.2007 te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise "IT. Com Albania" sh.p.k. qe kane te bejne me:

- 1- Shitjen Z. Sokol Kaso te aksioneve qe secili ortak zoteron ne shoqerine "IT Com Albania" sh.p.k. ne masen 2% te kapitalit themeltar secili ortak dhe en total ^% te kapitalit themeltar te shoqerise, duke lidhur me te Kontraten e Shitblerjes se kuotave para noterit.
- 2- Te shkarkohet nga detyra administratori i shoqerise IT Com Albania sh.p.k., Z. Gani Aga dhe te emerohet si administrator i shoqerise Z. Sokol Kaso.

Sa me siper une, **Sokol Kaso**, i biri i Selfos dhe i Feruzes, me dtl. 18.08.1974, me banim ne Tirane, ne cilesine e Administratorit te Shoqerise "**IT. COM ALBANIA**" sh.p.k, kerkoj te depozitoj kete Vendim per ndryshimin e administratorit ne Degen e Tatim Taksave Tirane dhe autorizoj Znj. Ilda Kokona, e bija e Asllanit dhe e Fatmires, me dtl. 15.06.1980, me banim ne Tirane, Rr:"Sitki Cico", identifikuar me pasaporten nr. Z1558727, qe te kryeje veprimet perkatese ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, Tirane.



IT COM. ALBANIA sh.p.k.

Sokol Kaso
Sokol Kaso
Administratori

EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR sh.p.k.”

GJENDJA E REGJISTRIMIT FILLESTAR

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NIPT)	K 71606003 W			
2. Data e Regjistrimit	Vgj. 36343 dt.15.09.2006			
3. Emri i Subjektit	“IT.COM ALBANIA”			
4. Forma ligjore	shpk			
5. Data e themelimit	04.09.2006			
6. Kohëzgjatja	Pa afat			
7. Selia	Rruga e Kavajes, Pallati i Ri i Madh tek ish parku i Udhëtareve,shk.1, Tirane			
8. Kapitali	100.000 leke			
9. Numri i pjesëve 9.1 vlera nominale				
10. Te dhëna mbi shlyerjen e kapitalit				
11. Objekti	Prodhim dhe montim i kompjuterave dhe makina për zyra, programe kompjuterike, ngritja e database, transport tokësor dhe ujor i mallrave. Shërbime në transport rrugor, ndërmjetësim në shitje makinerish, aktivitete të ndryshme ligjore, financiare që lidhen me IT.			
12. Përfaqësuesit ligjor 12.1 Afati i emërimit	Ermira Qosja			
13. Kufizime të kompetencave				
14. Ortaket	Avni Ponari	Leon Nimani	Vlahovic Darko	

Zca

Alen Kym



15.1 Pjesët e zotëruara	34%	33%	33%	
15.2 Përqindja e pjesëmarrjes				
15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit				
16. Të dhëna njoftuar vullnetarisht				
17. Të dhëna të tjera të re gjistrimit (psh. status pasiv, ekspert kontabël i autorizuar nëse ka njoftuar pezullimin e aktivitetit etj. nuk ka paguar kapitalin)	Pasiv	Pezull	EKA	Tjetër

HISTORIKU I REGJISTRIMIT

Data e regjistrimit	Ndryshimi i të dhënave të regjistruara
Me Vendimin Nr.36343 dt.15.09.2006 është vendosur:	Regjistrimi si person juridik i shoqërisë "IT. COM ALBANIA
Me vendimin nr.36343/1 dt.10.11.2006 është vendosur :	Miratimi i I shitjes se 34% te kuotave te ortakut Avni Ponari tek z.Gani Aga i cili behet ortak i ri i shoqërisë. Mbas kesaj ortake te shoqërisë jane Leon Nimani me 33% te kuotave, Vlahovic Darko me 33% te kuotave dhe Gani Aga me 34% te kuotave Shkarkimi i adminitratores znj.Ermira Qosja dhe emrimi i administratorit te ri z.Gani Aga
Me vendimin nr.36343/2 dt.26.12.2006 është vendosur	Ndryshimi i selise se shoqërisë ne adresen e re ne Rr. "Selim Brahja", tek pallatet (pallati 3-katesh, kati i pare), Sauk i Vjeter-Qender, Tirane
Me vendimin nr.36343/3 dt.05.04.2007 është vendosur	Ndryshimi i selise se shoqërisë ne adresen e re Bulevardi "Deshmoret e Kombit , Kulla e pare, Kati i Dyte, Tirane.
Me vendimin nr.36343/4 dt.10.07.2007 është vendosur	Shitjen z.Sokol Kaso te kuotave qe secili ortak zoteron ne shoqërine "It.Com Albania" shpk ne masen 2 % te kapitalit themeltar secili ortak dhe ne

J. Laci

Abon Krasni



	<p>total 6% te kapitalit themeltar te shoqerise duke u pranuar si ortak i ri ne shoqeri me 6% te kuotave te kapitalit themeltar.</p> <p>Mbas kesaj ortake te shoqerise jane z.Leon Nimani me 31% te kuotave, Vlahovic Darko me 31% te kuotave, Gani Aga me 32% te kuotave dhe Sokol Kaso me 6% te kuotave te kapitalit themeltar</p> <p>Shkarkimi i administratorit z.Gani Aga dhe emerimin si administrator te z.Sokol Kaso.</p>
Me date 01.10.2007 eshte vendosur	<p>Depozitimin e vendimit nr.36343/4 dt.10.07.2007 te gjyqtares Blerina Muça me permbajtje si me poshte:</p> <p>Shitjen z.Sokol Kaso te kuotave qe secili ortak zoteron ne shoqerine "It.Com Albania" shpk ne masen 2 % te kapitalit themeltar secili ortak dhe ne total 6% te kapitalit themeltar te shoqerise duke u pranuar si ortak i ri ne shoqeri me 6% te kuotave te kapitalit themeltar.</p> <p>Mbas kesaj ortake te shoqerise jane z.Leon Nimani me 31% te kuotave, Vlahovic Darko me 31% te kuotave, Gani Aga me 32% te kuotave dhe Sokol Kaso me 6% te kuotave te kapitalit themeltar</p> <p>Shkarkimi i administratorit z.Gani Aga dhe emerimin si administrator te z.Sokol Kaso</p>

Datë: 01.10.2007

Artan SYZIU

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i Përgjegjesit të Rregjistrimit)

Punoi : Johana Laçi

PULLE TAKSE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Noter: Robert KOLI
Studio: Rr. "Urani Pano", Pallati 11/Katesh
Nr. 14692 Rep.



VERTETIM NOTERIAL

Sot, me daten 04/09/2006 (dymije e gjashte), ditën e Henë, para meje Robert KOLI, noter në qytetin e Tiranës, me Seli si me sipër, u paraqiten personalisht:

Znj. Ermira QOSJA, e bija e Shaqirit, lindur me 07.04.1966 në Tiranë dhe banues në Tiranë, Rr. "Kongresi i Lushnjës", identifikuar nga Letërnjoftimi QH Nr. 284886, madhor dhe me zotesi të plote juridike për të vepruar, i cili më deklaroi se **Kerkesen e Shoqërisë "IT.COM ALBANIA" SHPK** e bashkangjitur e ka hartuar me vullnet të lirë dhe e neshkruan rregullisht për mua.
Une noter i vertetoj atë sipas ligjit.

NOTER
Robert KOLI




GARANCI PER REGJISTRIM NE GJYKATE
Nr 094 Data 05/09/2006

Me kete dokument vertetojme se **shoqeria IT. COM**
ALBANIA SHPK ka derdhur prane Banka Popullore Sha me
adrese Bulevardi Zogu I-re, Tirane, shumen prej **100.000 LEK**
(njqindmije lek) si kapital themeltar per regjistrim ne gjykate.

ORNELA ALIMADHI

As/ Drejtor i Deges



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Noter: Robert KOLI
Studio: Rr. "Urani Pano", Pallati 11/Katesh
Nr. 19691 Rep.
Nr. 2765 Kol.



VERTETIM NOTERIAL

Sot, me daten 04/09/2006 (dymije e gjashte), ditën e Hene, para meje Robert KOLI, noter ne qytetin e Tiranës, me Seli si me siper, u paraqiten personalisht:

Z. Avni PONARI, i biri Rexhepit, lindur me 28.07.1957 ne Tropoje dhe banues ne Tirane, Rr. "Nikolla Tupe", Pallati 11-katesh, identifikuar nga Pasaporta me Nr. Z1262110,

Z. Vlahovic DARKO, i biri i Momcila, lindur me 31.03.1970 ne Podgorica, P. Matovica dhe banues ne Podgorica, P. Matovica identifikuar nga Pasaporta e Republikës Federale te Jugosllavise Nr. 002280802,

Z. Leon NIMONI, i biri i Saliut, lindur me 08.03.1976 ne Kosove dhe banues ne Tirane, Pallatet Moskat, identifikuar nga Pasaporta e Republikës Federale te Jugosllavise Nr. 005103438,

te gjithë madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet me deklaruan se **Akt themelimin dhe Statutin e Shoqerise "IT.COM ALBANIA" SHPK** e bashkangjitur e kane hartuar me vullnet te lire dhe e neshkruan rregullisht para meje.

Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTER
Robert KOLI

*Perkthet me Gjuherre
/ Sreberkroete per zot. Vlahovic
HAKO me Leon Nimoni
HAKO me Leon Nimoni*



KERKESE

KERKUES:

Gani AGA, i biri i Muratit, lindur më 18.01.1971 në Pukë dhe banues në Sauk Tiranë, identifikuar nga Pasaporta Nr. Z0570888,

OBJEKT: Depozitimi ne Regjistrin Tregetar te Shoqerise "IT.COM ALBANIA" SHPK te nje ndryshimi ne administrimin e veprimtarise te saj.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", Ligji Nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare"

GJYKATES TE RRETHIT GJYQESOR TIRANE

Sot me date 25.10.2006, une Administratori i Shoqerise "IT.COM ALBANIA" SHPK, regjistruar ne Gjykaten e Rrethit Tirane me vendimin Nr. 36343 date 15.09.2006, duke u mbeshtetur ne Nenin 33 te Ligjit Nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetar", si dhe Ligjin Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" i kerkoj Gjykates te Rrethit Gjyqesor Tirane te beje depozitim ne Regjistrin Tregetar te kesaj Gjykate te vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise, Nr 1, date 20.10.2006 per te bere keto ndryshime:

Të shiten kuotat e Z. Avni Ponar në masën 34 (tridhjetëkatër) % Z. Gani AGA, duke lidhur me kontratën e Shitblerjes së Kuotave para noterit.

- Të shkarkojmë nga detyra e Administratorit të shoqërisë "IT.COM ALBANIA" SHPK Znj. Ermira QOSJA.

- Të emërohet në Administrator i Shoqerise "IT.COM ALBANIA" SHPK Z. Gani AGA.

Regjistrimin e Kontrates te Shitjes te Kuotave Nr. 17665 Rep. Nr. 3537 Kol. date 27/10/2006, duke pasqyruar ndryshimet si me poshte:

Bashkangituar ju perfaqsoj vendimin e Asambleses se Ortakeve dhe Kontraten e Shitjes se Kuotave.

KERKUESI
Gani AGA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Noter Robert KOLI
Selia:Rr."Urani Pano" Pa.11/katesh
Nr. 17666 Rep.


VERTETIM NOTERIAL

Sot, me daten 25/10/2006 (dymije e gjashte), para meje **Robert KOLI**, noter ne qytetin e Tiranës me Seli si me siper, u paraqiten personalisht:

Gani AGA, i biri i Muratit, lindur më 18.01.1971 në Pukë dhe banues në Sauk Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Pasaporta Nr. Z0570888, i cili ne cilesine e Administratorit te shoqerise deklaroi se **Kerkesen** per drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, e ka hartuar me vullnet te lire dhe nenshkroi regullisht para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.



NOTER
Robert KOLI



VENDIMI Nr. 1
Datë: 20.10.2006



I ASAMBLESE SË JASHTËZAKONËSHME
TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË

“IT.COM ALBANIA” SH.P.K

Sot në datë 20.10.2006, pranë Selisë së Shoqërisë “IT.COM ALBANIA” SHPK, në Tiranë, regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Tiranë me vendimin Nr. 36343 datë 15.09.2006, u mbledh Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë:

Z. Avni PONARI, zotërues i 34% të kapitalit,

Z. Leon NIMANI, zotërues i 33% të kapitalit,

Z. Vlahovic DARKO, zotërues i 33% të kapitalit,

Pasi u shqyrtua ecuria e deritanishme e Shoqërisë tonë si më lart, mbështetur në Statutin e Shoqërisë, Neni 29 dhe Neni 38, në përputhje të plotë me Legjislacionin në fuqi, me 100 % të votave

U VENDOS:

1. Të shiten kuotat e Z. Avni Ponari në masën 34 (tridhjetëkatër) % Z. Gani AGA, duke lidhur me të Kontratën e Shitblerjes së Kuotave para noterit.
2. Të shkarkojmë nga detyra e Administratorit të shoqërisë “IT.COM ALBANIA” SHPK Znj. Ermira QOSJA.
3. Të emërohet në Administrator i Shoqërisë “IT.COM ALBANIA” SHPK Z. Gani AGA.
4. Të depozitohet dokumentacioni i nevojshëm pranë Rregjistrimit Tregetar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për të bërë ndryshimet e nevojshme në Regjistrin përkatës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Shoqëria “IT.COM ALBANIA” SHPK

Avni PONARI

Leon NIMANI

Vlahovic DARKO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Noter: Robert Koli
Studio: Rr.Urani Pano, Pallati 11.Katesh
Nr. 19664 Rep.
Nr. — Kol.

PULLE TAKSE



VERTETIM NOTERIAL

Sot, me daten 25/10/2006 (dymijeegjashte), ditën e Hënë, para meje Robert KOLI, noter ne qytetin e Tiranës, me Seli si me sipër, u paraqit personalisht:

Z. Avni PONARI, i biri i Rexhepit, lindur me 28.07.1957 dhe banues ne Tirane, Rr. "Nikolla Tupe", Pall.10-katesh, Kati i 4, identifikuar nga Pasaporta Nr. Z1262110,

Z. Vlahovic DARKO, i biri i Momcila, lindur me 31.03.1970 ne Podgorica, P. Matovica dhe banues ne Podgorica, P. Matovica, identifikuar nga Pasaporta e Republikës Federale te Jugosllavise Nr. 002280802,

Z. Leon NIMONI, i biri i Saliut, lindur me 08.03.1976 ne Kosove dhe banues ne Tirane, Pallatet Moskat, identifikuar nga Pasaporta e Republikës Federale te Jugosllavise Nr. 005103438,

te gjithë madhore dhe me zotesi te plate juridike per te vepruar, te cilet ne pranine e perkthyesit te gjuhes serbe Leon NIMANI me deklaruan se Vendimin e Asamblesë se Qyteteve e Shqerise "IT.COM ALBANIA" SHPK e bashkangjitur kane hartuar dhe nenshkruar me vullnet te lire.

Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

Perkthyes

Leon NIMONI

Noter

Robert KOLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
Noter: Robert Koli
Studio: Rr: "Urani Pano" P11. Katësh
Nr 17661 Rep.
Nr 3537 Kol.



KONTRATË SHITJE KUOTASH
Sot më datë 27/10/2006 (dymijëegjashhtë), ditën e Martorit para meje Robert KOLI, noter në qytetin e Tiranës, me Seli si më sipër, u paraqitën personalisht palët:

SHITËSI:

Z. Avni PONARI, i biri i Rexhepit, lindur më 28.07.1957 dhe banues në Tiranë, Rr. "Nikolla Tupe", Pall.10-katësh, Kati i 4, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Pasaporta Nr. Z1262110,

BLERËSI:

Z. Gani AGA, i biri i Muratit, lindur më 18.01.1971 në Pukë dhe banues në Sauk, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Pasaporta Nr. Z0570888.
të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate si më poshtë:

Shitësi është ^{ortak} aksioner i 34 (tridhjetëkatër) % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "IT.COM ALBANIA" SHPK, regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës Nr. 36343 datë 15.09.2006.

Palët e mësipërme me vullnet të lirë, në mbështetje të Vendimit të Asamblesë së Shoqërisë "IT.COM ALBANIA" SHPK datë 20.10.2006, kanë rënë dakord që Z. Avni PONARI t'i shesë Z. Gani AGA ^{kontratë} aksionet që zotëron në Shoqërinë "IT.COM ALBANIA" SHPK në masën 34 % të kapitalit themeltar, me çmimin e shitjes prej 34.000 (tridhjetëkatërmijë) LEKE, shumë kjo e cila është likuiduar plotësisht nga Blerësi në favor të shitësit, jashtë kësaj zyre noteriale, pa asnjë pretendim të mëtejshëm nga palët.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitësi **Z. Avni PONARI** humbet pronësinë mbi aksionet e Shoqërisë "IT.COM ALBANIA" SHPK dhe pronari i tyre bëhet **Z. Gani AGA**, duke e regjistruar këtë blerje në Rregjistrin Tregëtar pranë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë.

Përfundimisht me këtë **KONTRATË SHITJE**, ^{kontratë} Aksionet e shoqërisë "IT.COM ALBANIA" SHPK rezultojnë si vijon:

Gani AGA me 34 %

Leon NIMANI me 33 %

Vlahovic DARKO me 33 %

Kjo kontratë shitje përpilohet në bazë të Vendimit të Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë "IT.COM ALBANIA" SHPK, datë 20.10.2006, bashkangjitur kësaj kontrate.

Kontrata u përpilua në katër kopje me vlerë të njëjtë ligjore dhe pasi u lexua në prezencën e palëve me zë të lartë u nënshkrua rregullisht prej tyre para meje.

Unë noter i vërtetoj atë sipas ligjit.

SHITËSI
Z. Avni PONARI

BLERËSI
Z. Gani AGA

NOTER
Robert KOLI

KERKESE

23. E. Breg
23 NOV 2006

KERKUESI: Gani AGA, i biri i Muratit, lindur me 18.01.1971 ne Puke, me banim ne Tirane, Qender-Kamez, identifikuar nga pasaporta Nr.Z0570888, ne cilesine e Administratorit te Shoqerise "IT. COM ALBANIA" SH.P.K.

OBJEKTI: Depozitim ne Regjistrin Tregetar te Shoqerise "IT. COM ALBANIA" SH.P.K. te ndryshimit te miratuar me Vendim nr. 2 date 21.11.2006 te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te shoqerise.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe Ligji nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare".

GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE

Une, Administratori i Shoqerise "IT. COM ALBANIA" SH.P.K. regjistruar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane me Vendimin Nr. 36343 date 15.09.2006, duke u mbeshtetur ne Ligjin nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe Ligjin nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare", i kerkoj Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane te beje depozitim ne Regjistrin Tregetar te kesaj Gjykate te Vendimit te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te Shoqerise Nr.2 date 21.11.2006 per te bere ndryshimin si me poshte vijon:

- te ndryshoje seline e shoqerise "IT. COM ALBANIA" SH.P.K. nga Rr:"Kavajes", Pallati i Ri i Madh tek ish Parku i Autobuzave, ne Rr:"Selim Brahja", tek pallatet (pallati 9-katesh, kati i pare), Sauk i vjeter-Qender, Tirane.
- te depozitoje ndryshimin ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Bashkangjitur eshte Vendimi Nr.2 date 21.11.2006 i Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te Shoqerise "IT. COM ALBANIA" SH.P.K.

KERKUESI
Gani AGA


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Noter: Robert Koli
Studio: Rr Urani Pano, Pallati 11-katesh
NR. 19057 REP.

VERTETIM NOTERIAL

Sot ne daten 22/11/2006 (dymije e gjashte), para meje noter Robert KOLI, noter ne qytetin e Tiranes, me Seli si me sipër, u paraqiten personalisht:

Z. Gani AGA, i biri i Muratit, lindur me 18.01.1971 ne Puke, me banim ne Sauk, Tirane, identifikuar nga pasaporta Z0570888, i cili ne cilesine e Administratorit te Shoqerise "IT. COM ALBANIA" SH.P.K. deklaroi se Kerkesen drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, e ka hartuar me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkroi rregullisht para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTER
Robert KOLI



Handwritten notes and signatures in the left margin, including 'Robert Koli' and 'Gani AGA'.

12

VENDIM Nr.2
Date 21.11.2006

I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME
TE ORTAKEVE TE SHOQERISE

“IT COM ALBANIA“ SH.P.K.



Sot me date 21.11.2006, prane selise se shoqerise “IT COM ALBANIA“ SH.P.K. ne Tirane, regjistruar si person juridik ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane me Vendimin Nr. 36343 date 15.09.2006, u mbledh Asambleja e Ortakeve te Shoqerise:

Z.Gani AGA, zoterues i 34% te kapitalit,

Z.Leon NIMANI, zoterues i 33% te kapitalit,

Z.Vlahovic DARKO, zoterues i 33% te kapitalit,

e cila me 100% te votave,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e selise se shoqerise “IT COM ALBANIA“ SH.P.K. nga Rr:“Kavajes“, Pallati i Ri i Madh tek ish-parku i Autobuzave, ne Rr:“Selim Brahja“, tek pallatet (pallati 3-katesh, kati i pare) Sauki vjeter-Qender,Tirane.
2. Caktimin e administratorit te shoqerise “IT COM ALBANIA“ SH.P.K. te depozitoje ndryshimet ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Shoqeria “IT COM ALBANIA“ SH.P.K.

Gani AGA

Leon NIMANI

Vlahovic DARKO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Noter: Robert Koli
Studio: Rr Urani Pano, Pallati 11-katesh
NR. 19392 REP.
NR. KOL.

PULLE TAKSE



VERTETIM NOTERIAL

Sot ne daten 06/12/2006 (dymijeegjashte), para meje noter Robert KOLI, noter ne qytetin e Tiranës, me Seli si me siper, u paraqiten personalisht:

Z. Gani AGA, i biri i Muratit, lindur me 18.01.1971 ne Puke, me banim ne Tirane, Qender-Kamez, identifikuar nga pasaporta Z0570888,
